**VENDIM**
**Nr. 47, datë 27.1.2021**

# PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT, TË NJË PJESE TË PRONËS SË PALUAJTSHME ME SIPËRFAQE PREJ 19 000 M$^2$, NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8340, ME NUMËR PASURIE 8/76, ME SIPËRFAQE PREJ 46 266 M$^2$, ME EMËRTIMIN "STACION HEKURUDHOR", TIRANË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 714, DATË 20.10.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT TE MINISTRIA E DREJTËSISË, TË SIPËRFAQES 46 266 M², NË ZONËN KADASTRALE NR. 8340, ME NUMËR PASURIE 8/76, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 120, DATË 4.3.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13 dhe 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, si dhe të pikës 1, të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të një pjese të pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) m$^2$, nga trualli funksional i pronës në zonën kadastrale 8340, me numër pasurie 8/76, me emërtim "Stacion hekurudhor", Tiranë, me sipërfaqe 46 266 (dyzet e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m$^2$, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim përdorimin e saj për zhvillimin e qëndrueshëm në turizëm.
2. Sipërfaqja prej 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) m$^2$ e truallit, e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 714, datë 20.10 2011, të Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

| NR_PIKE | X | Y |
|---|---|---|
| 1 | 484538.43 | 4578477.64 |
| 2 | 484541.24 | 4578479.09 |
| 3 | 484575.72 | 4578496.81 |
| 4 | 484589.06 | 4578503.19 |
| 5 | 484595.4 | 4578506.23 |
| 6 | 484599.57 | 4578498 |
| 7 | 484616.69 | 4578464.21 |
| 8 | 484623.26 | 4578450.6 |
| 9 | 484627.13 | 4578442.69 |
| 10 | 484628.8 | 4578439.28 |
| 11 | 484629.34 | 4578438.42 |
| 12 | 484629.69 | 4578437.68 |
| 13 | 484628.15 | 4578436.93 |
| 14 | 484667.33 | 4578355.97 |
| 15 | 484668.65 | 4578356.66 |
| 16 | 484683.81 | 4578325.33 |
| 17 | 484648.86 | 4578307.25 |
| 18 | 484640.6 | 4578303.83 |
| 19 | 484633.52 | 4578300.55 |
| 20 | 484632.7 | 4578299.62 |
| 21 | 484628.79 | 4578297.84 |
| 22 | 484622.06 | 4578294.52 |
| 23 | 484615.6 | 4578291.33 |
| 24 | 484611.92 | 4578289.51 |
| 25 | 484602.28 | 4578285.12 |
| 26 | 484580.38 | 4578275.24 |